

Për secilën nga pyetjet qarkoni alternativën e saktë. Më pas plotësoni përgjigjen në fletën e përgjigjeve.

1. Lexoni këtë temë eseje: "Zgjidhni një grup të cilit ju i përkisni (qytet, shkollë, ekip) dhe shpjegoni pse përfshirja në të është e rëndësishme për ju."

Cila nga alternativat e mëposhtme është një *tezë* e përshtatshme për këtë ese?

1 pikë

- A) Për mua ka vlerë të jesh anëtar i një skuadre futbollit, pasi të bën të ndihesh i shëndetshëm, i gëzuar dhe i disiplinuar.
- B) Disa nxënës ankohen shumë për shkollën, por jo unë, pasi është e rëndësishme ta ndjek atë çdo ditë.
- C) Disa njerëz nuk e konsiderojnë komunitet një qytet me këto përmasa, por njerëzit që jetojnë këtu, e dinë vlerën e të qenit së bashku.
- D) Edhe pse vendlindja ime përfshin njerëz të kulturave të ndryshme, të gjithë e dimë si të qëndrojmë së bashku, duke lënë mënjanë ndryshimet që kemi, për të kaluar sa më mirë me njëri-tjetrin.
2. Mësuesi ju ka dhënë për të shkruar një *ese narrative* në lidhje me një periudhë të jetës suaj, kur keni kapërcyer me sukses një vështirësi.

1 pikë

Cila nga alternativat e mëposhtme është një *hyrje* e përshtatshme dhe efektive për një ese të tillë?

- A) Mësuesi i bibliotekës më prezantoi me një grup nxënësish të vitit të parë dhe unë sërish pyeta veten pse kisha dalë vullnetar për të lexuar para tyre. Zëri im u drodh me nervozizëm kur i përshëndeta, por, më pas, pashë fytyrat e tyre të ndritshme që shfaqnin interes ndaj meje. Hapa librin të një histori dhe u mbusha me frymë. Pastaj, me një zë të fortë, lexova fjalinë e parë.
- B) Shkolla është burimi i shumë prej vështirësive më të mëdha me të cilat përballen të rinjtë. Zhvillimi i testeve dhe i detyrave është një nga sfidat më të pranishme. Madje, më e vështira është të merresh edhe me probleme të jetës së përditshme, për shembull, si t'ia dalësh me mësuesit dhe nxënësit e tjerë.
- C) Të gjithë përballen me pengesa në jetë, por testi i vërtetë i karakterit tuaj është se si përgjigjeni ndaj atyre pengesave. Të bësh më të mirën tënde, rrit mundësinë e suksesit dhe të ndihmon të përgatitesh për sfidat e tjera me të cilat do të ndeshesh në jetë. E rëndësishme është të jesh gali për gjithçka me të cilën mund të përballësh.
- D) Gjatë jetës sime jam përballur me shumë pengesa. Një nga më të vështirat për t'u kapërcyer ka qenë suksesi i vëllait tim më të madh në shkollë. Ai është jashtëzakonisht inteligjent dhe shumica e lëndëve duket që nuk është asgjë për të. Unë duhet të bind veten dhe të tjerët se, megjithëse më duhet të punoj pak më shumë, sërish jam po aq i zgjuar sa ai.

3. Cila nga alternativat e mëposhtme është një *tezë* e përshtatshme dhe efektive për një *ese bindëse* që lidhet me vullnetarizmin?

1 pikë

- A) Edhe pse asnjëherë nuk kërkohet vullnetarizmi për të ndihmuar të tjerët, ai sërish inkurajohet.
- B) Ka shumë arsye për të dalë vullnetar në ndihmë të atyre që kanë nevojë.
- C) Unë dola vullnetar për të ndihmuar babanë në pastrimin e oborrit dhe, sinqerisht, u kënaqa shumë.
- D) Puna vullnetare të jep shumë përvojë dhe luan një rol të rëndësishëm në komunitet.

4. Cila renditje i organizon fjalitë e mëposhtme sipas modelit të krahasim-kontrastit?

1 pikë

1) Vijat në kurrizin e tigrin e fshehin mirë atë në xhungël, ndërsa lëkura e verdhë e luanit është e përshtatshme me terrenin ku ai jeton. 2) Luanët dhe tigrat janë dy shembuj të felineve të mëdhenj dhe të egër. 3) Megjithëse nga pamja e jashtme ata ndryshojnë shumë, sërish kanë gjëra të përbashkëta. 4) Të dy përdorin lëkurën e tyre si kamuflim në mjediset specifike.

- A) 2, 3, 4, 1
 B) 2, 1, 3, 4
 C) 1, 2, 4, 3
 D) 1, 3, 2, 4

5. Lexoni paragrafin e mëposhtëm:

1 pikë

Barka filloi të rrëshqiste me shpejtësi përgjatë lumit të rrëmbyer, ndërsa katër njerëzit që ndodheshin në të, bërtisnin nga euforia. Zemrat e tyre rrihnin fort, ndërsa manovronin me shkathësi lopatat përmes ujërave të trazuara. Madje edhe Turi, i cili fillimisht ishte ndër i shqetësuar në lidhje me udhëtimin me barkë, e harroi frikën kur valët e akullta përplaseshin mbi të. Papritur, ai vështrroi skajet e mprehta të një shkëmbi të dhëmbëzuar që iu shfaq përpara.

Cila nga fjalitë e mëposhtme mund të vijojë në të njëjtin stil aksionin e nisur në paragrafin e dhënë më sipër?

- A) Duke u përqendruar, Turi u përpoq të kujtonte procedurën e saktë për ta kthyer barkën në një pozicion të sigurt.
- B) Ndërkohë, uji i flohtë i lumit vazhdoi të përplasej në anët e barkës duke i bërë qull Turin dhe miqtë e tij.
- C) Turi e dinte që ai dhe miqtë e tij ishin të përgatitur për t'ia dalë në situata të tilla.
- D) **Turi u hodh në të djathtë për të shmangur shkëmbin dhe gati e përmbysi barkën.**

6. Cila nga alternativat sjell një përfundim krahasues mbi informacionin e marrë nga dy burimet e dhëna më poshtë?

1 pikë

Burimi I

muzikë [emër] - Fjala shqipe *muzikë* vjen nga fjala e vjetër franceze *musique*, fjala latine *musica* dhe përfundimisht fjala greke *mousike*.

Burimi II

Fjala greke *mousike* i referohet çdo prodhimi artistik të tillë, si: artet pamore, poezia apo kënga që drejtohen nga muzat. Muzat ishin hyjni/perëndi që frymëzonin artistët në kategori të ndryshme të artit. Sipas grekëve të lashtë, ato të gjitha mbledheshin bashkë nën emërtimin *muzikë*.

- A) Të dyja burimet tregojnë se gjuha greke dhe latine janë shumë të ngjashme.
- B) Të dyja burimet përshkruajnë se si fjala *muzikë* është e lidhur me një koncept shumë të përgjithshëm të artit.
- C) **Burimi i parë na jep prejardhjen e përgjithshme të një fjale në gjuhën shqipe; burimi i dytë shpjegon origjinën specifike të kuptimit të asaj fjale.**
- D) Burimi i parë përshkruan se si përdoret një fjale në gjuhën shqipe. Burimi i dytë shpjegon se përdorimi është i pasaktë.

7. Cila fjali nga artikulli i mëposhtëm përmban një informacion të cilit i duhet treguar burimi?

1 pikë

1) Fushata "Të hamë shëndetshëm" që filloi kohët e fundit në shkollën tonë, u kujton nxënësve të kenë kujdes me sasinë e sheqerit që konsumojnë, madje edhe nga burime të shëndetshme, siç janë lëngjet e frutave. 2) Shumë njerëz mund të mos e dinë se sa sheqer përmban lëngu i frutave. 3) Për shembull, shumica e shokëve të mi më thonë se ata zgjedhin të pinë lëngje frutash, pasi mendojnë se janë më të shëndetshme se pijet me gaz. 4) Ekspertët e ushqimit tregojnë se lëngu i frutave është i pasur me lëndë ushqyese të tilla, si: vitamina C, kalciumi etj. 5) Megjithatë, nëse ju shikoni etiketat në shishet e lëngjeve të frutave, do të vini re se ato përmbajnë shumë sheqer.

- A) **Fjalja 4**
- B) Fjalja 5
- C) Fjalja 1
- D) Fjalja 2

8. Reklama e një parku paraqet disa fëmijë duke vrapuar në fushë, të tjerë duke ushqyer zogjtë, duke notuar në liqen apo duke pedaluar një varkë. Pse janë zgjedhur këto imazhe për të reklamuar parkun?

1 pikë

- A) Imazhet e fëmijëve inkurajojnë familjet të përdorin parkun.
- B) Fëmijëve u pëlqen të kalojnë kohë jashtë në natyrë.
- C) Ushtrimi është i rëndësishëm për të pasur një shëndet të mirë.
- D) **Parku ofron një shumëllojshmëri veprimtarish.**

9. Cila nga fjalitë e paragrafit në vijim tregon qëndrimin e autorit në lidhje me interesin që miku i tij kishte për natyrën? **1 pikë**

Kur miku im i ngushtë ishte nxënës shkolle, ngrihej herët dhe luante jashtë çdo ditë për orë të tëra. Atij i pëlqente të ngjitej në pemë dhe të mblidhte (gjatë aventurave të tij) gurë të llojeve të ndryshme. Më vonë ai nisi të ndërmernte udhëtime të gjata mes pyjeve dhe shtigjeve malore. Atëherë më dukej i çuditshëm interesi i tij për natyrën. Sot e kam kuptuar se, që në atë moshë, miku im vlerësoi diçka që mua m'u deshën vite për ta kuptuar.

- A) Atij i pëlqente të ngjitej në pemë dhe të mblidhte (gjatë aventurave të tij) gurë të llojeve të ndryshme.
- B) Kur miku im i ngushtë ishte nxënës shkolle, ngrihej herët dhe luante jashtë çdo ditë për orë të tëra.
- C) **Sot e kam kuptuar se, që në atë moshë, miku im vlerësoi diçka që mua m'u deshën vite për ta kuptuar.**
- D) Më vonë ai nisi të ndërmernte udhëtime të gjata mes pyjeve dhe shtigjeve malore.

10. Mbi cilin model organizues është ndërtuar struktura e përgjithshme e këtij teksti? **1 pikë**

Mungesa e salmonit në ujërat e oqeanëve tona është sinjal i një krize. Njerëzit që jetojnë në qytete, duhet të kuptojnë se zgjedhjet e tyre ndikojnë në mjedisin natyror që ne të gjithë e duam. Pesticidet dhe plehurat e përdorura në fusha thithen nga toka dhe përfundojnë në ujërat e planetit. Nivelet e oksigjenit bien, algat shtohen dhe peshqit zhduken.

- A) Rend kronologjik.
- B) Problem dhe zgjidhje.
- C) **Shkak dhe pasojë,**
- D) Krahasim dhe kontrast.

11. Cila nga fjalitë e tekstit të pyetjes 10 shpreh një fakt? **1 pikë**

- A) Mungesa e salmonit në ujërat e oqeanëve tona është sinjal i një krize.
- B) **Pesticidet dhe plehurat e përdorura në fusha thithen nga toka dhe përfundojnë në ujërat e planetit.**
- C) Ne të gjithë e duam mjedisin natyror.
- D) Njerëzit që jetojnë në qytete, duhet të kuptojnë se zgjedhjet e tyre ndikojnë në mjedisin natyror.

12. Cila fjali është *teza* e këtij paragrafi? **1 pikë**

Megjithëse më pëlqen të shkruaj, zakonisht krijoj vetëm histori të shkurtra. Për mua, historitë e shkurtra janë më të lehta për t'u shkruar sesa shkrimi i një romani. Të shkruaja një roman, do të ishte me të vërtetë një arritje e jashtëzakonshme. Një libër i tillë kërkon shumë imagjinatë, përqendrim dhe përkushtim. Ndonjëherë çuditëm se si disa njerëz ia dalin ta shkruajnë.

- A) Megjithëse më pëlqen të shkruaj, zakonisht krijoj vetëm histori të shkurtra.
- B) Për mua, historitë e shkurtra janë më të lehta për t'u shkruar sesa shkrimi i një romani.
- C) Një libër i tillë kërkon shumë imagjinatë, përqendrim dhe përkushtim.
- D) **Të shkruaja një roman, do të ishte me të vërtetë një arritje e jashtëzakonshme.**

13. Fëmijët po shikojnë shumë televizor. Studimet kanë treguar se ata shpenzojnë më tepër kohë para televizorit sesa për të mësuar. Sipas studimeve, fëmijët shpenzojnë vetëm 35 minuta për të biseduar me prindërit e tyre, ndërkohë që kalojnë 4-5 orë në ditë përpara televizorit. Po sipas studimeve, fëmijët që shikojnë 4 orë filma vizatimorë të shtunën në mëngjes, do të shikojnë gjithashtu 200 reklama që lidhen me ushqimin e pashëndetshëm.

Cila nga fjalitë e mëposhtme është shembull i një të dhëne të nënkuptuar? **1 pikë**

- A) Fëmijët nuk shpenzojnë shumë kohë duke folur me prindërit e tyre.
- B) **Fëmijët që shikojnë shumë filma vizatimorë të shtunën në mëngjes, mund të shtojnë në peshë.**
- C) Fëmijët shikojnë televizor më shumë sesa mësojnë.
- D) Studimet tregojnë se fëmijët shikojnë televizor më shumë sesa duhet.

14. Cili ilustrim do t'i ndihmonte më shumë lexuesit të kuptonin një artikull për shpellën më të madhe në botë? **1 pikë**

- A) Një listë e eksploruesve të shpellave.
- B) Një vizatim i pajisjeve të eksploratorëve të shpellave.
- C) Një grafik i dimensioneve të shpellave më të mëdha në botë.
- D) **Një foto e pamjes së brendshme të shpellës.**

15. Fotoja e mëposhtme përcjell te shikuesi mesazhin:

1 pikë



- A) njeriu në sfidë me kohën.
- B) njeriu në sfidë me shoqërinë.
- C) njeriu në sfidë me teknologjinë.
- D) njeriu në sfidë me natyrën.

5 / 12

Teksti i dhënë më poshtë nuk është i saktë nga ana gjuhësore. Lexojeni me kujdes dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim.

Saranda, mes 6 vendeve që duhet të vizitohet tani para se të gjithë ta bëjnë

[1] Qyteti bregdetar i Sarandës me ujërat e tij të kristalta, plazhet mahnitëse dhe monumentet e shumta kulturore dhe arkeologjike, janë renditur ndër 6 vendet që duhet të vizitohet tani para se të gjithë ta bëjnë, sipas ekspertës së udhëtimeve, Patricia Schultz, - shkruan "Business Insider".

[2] Duke reflektuar për mënyrat e shumta në të cilat udhëtimi ka ndryshuar në mbi 30 vjet, Schultz vë në dukje se media sociale kanë nxjerrë në dritë shumë vende më pak të njohur.

[3] "Unë e di se bota po bëhet më e arritëshme. Vende që do të ishin lista jonë e dëshirave, tani janë", tha ajo, duke shpjeguar se ndihet që Evropa, për shembull, është bërë një lloj destinacionesh "kur jam në pension", duke e krahasuar atë me "pizhame të rehatshme".

[4] E dini ku po shkojnë njerëzit? [5] Apo, edhe më mirë, ku duhet të shkojnë njerëzit? [6] Vazhdoni të lëvizni për të parë gjashtë vendet që parashikon Schultz, të cilat do të jenë pikat e nxehta të radhës, ku bën pjesë edhe qyteti i Sarandës.

[7] "Ka një vijë të bukur bregdetare dhe shumë turistë të rinj që shkojnë atje", - shprehet Schultz.

[8] Ajo shlon se Saranda është gjithashtu një vend shumë i lirë dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca.

[9] "Është e ngjashme me Gjeorgjinë (kjo e fundit është më e njohur); ka të njëjtën natyrë të stinës së verës, si edhe ushqim të mirë", - shkruan Schultz.

16. Nëse do ta shprehim titullin e fragmentit të dhënë me një fjali së cilës i mungon folja (pa e dëmtuar kuptimin e fjalisë), varianti i duhur do të ishte: 1 pikë

- A) Saranda, qyteti mes 6 vendeve që duhet vizituar
- B) Saranda, qyteti që duhet vizituar sa më parë
- C) Saranda, qyteti mes 6 vendeve për t'u vizituar sa më parë
- D) Saranda, qyteti për t'u vizituar nga të gjithë

17. Në cilën nga fjalitë e mëposhtme *fjalë* apo *tojë fjalesh* në përberje të saj tregojnë burimin e kumtimit? 1 pikë

- A) "Është e ngjashme me Gjeorgjinë (kjo e fundit është më e njohur); ka të njëjtën natyrë të stinës së verës, si edhe ushqim të mirë", shkruan Schultz.
- B) "Ka një vijë të bukur bregdetare dhe shumë turistë të rinj që shkojnë atje", shprehet pa hezitim Schultz.
- C) Qyteti bregdetar i Sarandës me ujërat e tij të kristalta, plazhet mahnitëse dhe monumentet e shumta kulturore dhe arkeologjike, janë renditur ndër 6 vendet që duhet të vizitohet tani para se të gjithë ta bëjnë, sipas ekspertës së udhëtimeve, Patricia Schultz, - shkruan "Business Insider".
- D) Duke shpjeguar ajo tha se ndihet që Evropa, për shembull, është bërë një lloj destinacionesh "kur jam në pension", duke e krahasuar atë me "pizhame të rehatshme".

sipas ekleries së udhëtimeve, Patricia Schultz, - shkruan "Business Insider".
D) Duke shpjeguar ajo tha se ndihet që Evropa, për shembull, është bërë një lloj destinacionesh "kur jam në pension", duke e krahasuar atë me "pëlhame të rrahshme".

18. Për të rritur interesin e lexuesve ndaj qytetit të Sarandës, duhet të shtohet edhe një fjali në fund të tekstit.

Cila nga fjaltë e mëposhtme e kryen më mirë këtë funksion?

1 pikë

- A) Pra, Saranda nuk është e vetmja që duhet vizituar.
B) Besojmë se ka ardhur koha për një vizitë në qytetin e Sarandës.
C) Mëkullitë e Sarandës kapërcejnë çdo përhyrim tuajin mbi qytetin.
D) Si përfundim, a ju pëlqeu Saranda?

19. Në tekstin e mëposhtëm mundohen detaje të nevojshme për besueshmërinë e tij. Nëse do t'i shtisim paragrafin e mëposhtëm siparus, ku duhet ta vendosim atë?

1 pikë

Patricia Schultz është autorja e bestsellerit të "New York Times"it, "1000 vende për tu parë para se të vdesësh", një libër udhëimesh, së cilës i janë dhënë mëllova udhëtarë, që kur u botua për herë të parë në vitin 2003.

- A) Pas fjaltë [1]
B) Pas fjaltë [2]
C) Pas fjaltë [6]
D) Pas fjaltë [10]

20. Nëse do ta zgjeroni fjaltë [8] me një rrethim të veçantë, strukturë e saktë do të ishte:

1 pikë

- A) Ajo shton se Saranda, e vendosur në jug të vendit, është gjithashtu një vend shumë i liri dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca.
B) Ajo shton se Saranda, qyteti i bukur jugor, është gjithashtu një vend shumë i liri dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca.
C) Ajo shton se Saranda është gjithashtu një vend shumë i liri dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca, sikurse janë edhe qyteti e tjera bregdetare.
D) Ajo shton se Saranda, në ditët e sotme, është gjithashtu një vend shumë i liri dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca.

21. Cil nga variantet e mëposhtme përban një emër të dygjuhëshëm?

1 pikë

- A) Ajo, edhe më mirë, ku duhet të shkruajë rrethit?
B) Ajo ka të njëjtin natyrë të stinës së verës me Gjeorgjinë.
C) Schultz ve në dukje se media sociale kanë ndjerrë në ditë shumë vende më pak të njohur.
D) Ka një vje të bukur bregdetare dhe shumë turistë të rinj që shkojnë atje.

22. Cila nga fjaltë është ndërlikuar saktë sipas raporteve sintaksore të gjymtyrëve të saj?

1 pikë

- A) "Është e ngjashme me Gjeorgjinë (ajo e fundit është më e njohur), ka të njëjtin natyrë të s' edhe ushqim të mirë", - shkruan Schultz.
B) Qyteti bregdetar i Sarandës me ujrat e tij të kristalta, plazhet mahutuese dhe monumentet e shpirtërishtë, janë rënditë ndër 6 vendet që duhet të vizitohet tani para se të gjithe të bëjnë, sipas udhëimeve, Patricia Schultz, - shkruan "Business Insider".
C) "Vende që do të ishin lista jonë e dëshirave, tani janë", - tha ajo, duke shpjeguar se ndihet që Evropa, për shembull, është bërë një lloj destinacionesh "kur jam në pension".
D) Duke reflektuar për mënyrat e shumta në të cilat udhëtimi ka ndryshuar në mbi 30 vjet, Schultz ve në dukje se media sociale kanë ndjerrë në ditë shumë vende më pak të njohur.

23. Cila nga alternativat e mëposhtme ka një gabim drejtshkrimor?

1 pikë

- A) Ajo shton se Saranda është gjithashtu një vend shumë i liri dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca.
B) E dihet ku po shkojnë rrethit?
C) Ka një vje të bukur bregdetare dhe shumë turistë të rinj që shkojnë atje.
D) Ujë e di se bota po bëhet më e artëshme.

Lexoni tekstin e mëposhtëm, marrë nga eseja e prof. Eqrem Çabejtit "Fan Noli ynë", dhe përgjiguni pyetjeve 24-30.

Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore atë më vete në literaturën shqiptare. Ai nuk është poet i lartshëm vërtetë, po është shkëlqimtar i gjatë të dësht. Në fushën e kësaj literature ai nuk është një fill bar që sot bëron e nesër thahet, nuk është as lule, që sot shkëlqon e nesër vyehtë. Ai na paraqet si një fis i mocës e plot gdhënjë fis i vetmuar, po me mënyrë ngulur mirë në të thëllat e dësht. Ë kështu mbetet edhe gjaba e tij. Ajo nuk leshon aromën e luleve, po mban eron e shëndoshë të dësht. Ka dhe diçka prej pikash të rëndë e të ndhota, në të shprehjet ana e rëndë e jetës shqiptare.

24. Në fjaltë: "Ai na paraqet si një fis i mocës e plot gdhënjë", fjaltë plot është përdorur si

1 pikë

- A) përemër i pacaktuar,
B) parafrazi,
C) pjesëz,
D) ndajfolje mënyre.

25. Nëse do ta rishkruajmë fjaltë: "Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore atë më vete në literaturën shqiptare", duke e vendosur foljen në mënyrën habitore (pa ndryshuar kategorinë e (ton), varianti i duhur do të jetë:

1 pikë

- A) Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore atë më vete në literaturën shqiptare.
B) Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore ndenjsh më vete në literaturën shqiptare.
C) Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore qenka më vete në literaturën shqiptare.
D) Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore ndenjka më vete në literaturën shqiptare.

26. Në fjaltë: "... atë shprehjet ana e rëndë e jetës shqiptare.", fjaltë me të zezë i referohet

1 pikë

- A) gjuhës së veprës së Nolit.
B) Fan Nolit si shkëlqimtar.
C) letërsisë shqiptare.
D) pasardhës të gjuhës shqipe.

27. Në cilin nga fjaltë e mëposhtme është përdorur folja kalimtare?

1 pikë

- A) Ai na paraqet si një fis i mocës e plot gdhënjë.

18. Për të rritur interesin e lexuesve ndaj qytetit të Sarandës, duhet të shtohet edhe një fjali në fund të tekstit.

Cila nga fjalitë e mëposhtme e kryen më mirë këtë funksion?

1 pikë

- A) Pra, Saranda nuk është e vetmja që duhet vizituar.
- B) **Besojmë se ka ardhur koha për një vizitë në qytetin e Sarandës.**
- C) Mrekullitë e Sarandës kapërcejnë çdo përftyrim tuajin mbi qytetin.
- D) Si përfundim, a ju pelqeu Saranda?

19. Në tekstin e mësipërm mungojnë detaje të nevojshme për besueshmërinë e tij. Nëse do t'i shtonim paragrafin e mëposhtëm sqarues, ku duhet ta vendosim atë?

1 pikë

Patricia Schultz është autorja e bestsellerit të "New York Times"-it, "1000 vende për t'u parë para se të vdesësh", një bibël udhëtimesh, së cilës i janë drejtuar miliona udhëtarë, që kur u botua për herë të parë në vitin 2003.

- A) **Pas fjalisë [1]**
- B) Pas fjalisë [2]
- C) Pas fjalisë [6]
- D) Pas fjalisë [10]

20. Nëse do ta zgjerohim fjalinë [8] me një rrethanor të veçuar, struktura e saktë do të ishte:

1 pikë

- A) Ajo shton se Saranda, e vendosur në jug të vendit, është gjithashtu një vend shumë i lirë dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca.
- B) Ajo shton se Saranda, qyteti i bukur jugor, është gjithashtu një vend shumë i lirë dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca.
- C) Ajo shton se Saranda është gjithashtu një vend shumë i lirë dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca, sikurse janë edhe qytetet e tjera bregdetare.
- D) **Ajo shton se Saranda, në ditët e sotme, është gjithashtu një vend shumë i lirë dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca.**

21. Cili nga variantet e mëposhtme përmban një emër të dygjimshëm?

1 pikë

- A) Apo, edhe më mirë, ku duhet të shkojnë njerëzit?
- B) Ajo ka të njëjtën natyrë të stinës së verës me Gjeorgjinë.
- C) **Schultz vë në dukje se media sociale kanë nxjerrë në dritë shumë vende më pak të njohur.**
- D) Ka një vijë të bukur bregdetare dhe shumë turistë të rinj që shkojnë atje.

6 / 12

22. Cila nga fjalitë është ndërtuar saktë sipas raporteve sintaksore të gjymtyrëve të saj?

- A) **"Është e ngjashme me Gjeorgjinë (kjo e fundit është më e njohur); ka të njëjtën natyrë të stinës së verës, si edhe ushqim të mirë", - shkruan Schultz.**
- B) Qyteti bregdetar i Sarandës me ujërat e tij të kristalta, plazhet mahnitëse dhe monumentet e shumta kulturore dhe arkeologjike, janë renditur ndër 6 vendet që duhet të vizitohet tani para se të gjithë ta bëjnë, sipas ekspertës së udhëtimeve, Patricia Schultz, - shkruan "Business Insider".
- C) "Vende që do të ishin lista jonë e dëshirave, tani janë", - tha ajo, duke shpjeguar se ndihet që Evropa, për shembull, është bërë një lloj destinacionesh "kur jam në pension".
- D) Duke reflektuar për mënyrat e shumta në të cilat udhëtimi ka ndryshuar në mbi 30 vjet, Schultz vë në dukje se media sociale kanë nxjerrë në dritë shumë vende më pak të njohur.

23. Cila nga alternativat e mëposhtme ka një gabim drejtshkrimor?

1 pikë

- A) Ajo shton se Saranda është gjithashtu një vend shumë i lirë dhe i shkëlqyer për të punuar nga distanca.
- B) E dini ku po shkojnë njerëzit?
- C) Ka një vijë të bukur bregdetare dhe shumë turistë të rinj që shkojnë atje.
- D) **Unë e di se bota po bëhet më e arritëshme.**

Lexoni tekstin e mëposhtëm, marrë nga eseja e prof. Eqrem Çabejit "Fan Noli ynë", dhe përgjigjuni pyetjeve 24-30.

Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore rri më vete në literaturën shqiptare. Ai nuk është poeti i lartësive eterike, po është shkrimtar i plisit të dheut. Në fushën e kësaj literature ai nuk është një fill bar që sot bleron e nesër thahet; nuk është as lule, që sot shkelqen e nesër vyshket. Ai na paraqitet si një lis i moçëm e plot gdhenj: lis i vetmuar, po me rrënjë ngulur mirë në të thellat e dheut. E këtu mbetet edhe gjuha e tij. Ajo nuk lëshon aromën e luleve, po mban erën e shëndoshë të dheut. Ka dhe diçka prej pikash të rënda e të hidhëta: në të shprehet ana e rëndë e jetës shqiptare.

24. Në fjalinë: "*Ai na paraqitet si një lis i moçëm e plot gdhenj*", fjala **plot** është përdorur si: **1 pikë**
- A) përemër i pacaktuar,
B) parafjalë,
C) pjesëz,
D) ndajfolje mënyre.
25. Nëse do ta rishkruajmë fjalinë: "*Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore rri më vete në literaturën shqiptare*", duke e vendosur foljen në mënyrën habitore (pa ndryshuar kategoritë e tjera), varianti i duhur do të jetë: **1 pikë**
- A) Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore rrika më vete në literaturën shqiptare.
B) Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore ndenjsh më vete në literaturën shqiptare.
C) Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore qenka më vete në literaturën shqiptare.
D) Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore ndenjka më vete në literaturën shqiptare.
26. Në fjalinë: "... **në të** shprehet ana e rëndë e jetës shqiptare.", fjala me të zeza i referohet: **1 pikë**
- A) gjuhës së veprës së Nolit.
B) Fan Nolit si shkrimtar.
C) letërsisë shqiptare.
D) pasurisë së gjuhës shqipe.
27. Në cilën nga fjalitë e mëposhtme është përdorur folja kalimtare? **1 pikë**
- A) Ai na paraqitet si një lis i moçëm e plot gdhenj.
B) Në fushën e kësaj literature ai nuk është një fill bar.
C) Fan Noli rri më vete në literaturën shqiptare.
D) Gjuha e tij mban erën e shëndoshë të dheut.
28. Në fjalinë: "*Ai nuk është poeti i lartësive eterike, po është shkrimtar i plisit të dheut, **prandaj** Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore rri më vete në literaturën shqiptare.*", lidhëza e nënvizuar është: **1 pikë**
- A) bashkërenditëse përmbyllëse,
B) bashkërenditëse veçuese,
C) nënrenditëse rrjedhimore,
D) nënrenditëse kushtore.
29. Cila nga fjalitë e mëposhtme zbaton rregullat e shkrimit të ligjëratës së drejtë?
- A) Çabeji shprehet se "Ai nuk është poeti i lartësive eterike, po është shkrimtar i plisit të dheut."
B) "Ai nuk është poeti i lartësive eterike, po është shkrimtar i plisit të dheut", - shprehet Eqrem Çabeji.
C) "Ai nuk është poeti i lartësive eterike, shprehet Çabej, - po është shkrimtar i plisit të dheut."
D) "Ai nuk është poeti i lartësive eterike," - shprehet Çabej, po është shkrimtar i plisit të dheut."
30. Funkcioni i grupit të fjalëve të paraprirë **nga pjesorja** në fjalinë: "*Ai na paraqitet si një lis i moçëm e plot gdhenj: lis i vetmuar, po me rrënjë ngulur mirë në të thellat e dheut.*" është ai: **1 pikë**
- A) i rrethorit,
B) i kundrinorit të drejtë,
C) i kundrinorit të zhdrejtë,
D) i përcaktorit.



PJESA II – LETËRSI

Lexoni poezinë dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim.

O greminë! O fusha pllajash! O shkëmbonj! O brigje t'artë!
O ju qiej shkretëtirash tej-për-tej aq të këqyrshmë!
Ti përflakje mëngjezore! Harg ylberi-i shtatëngjyrshmë!
Botë yjsh! botë hënash! Botë djejs me gji të zjarrtë!

Bjenë fellë mënt' e mija dhe çuditen dyke pyetur:
Në lëvisni-a në përdridhi, në valoni-a në këndon,
Në me sulmë të vërtikshme çmëndurisht ju fluturoni,
E prej sysh më bjenë lotë posi helm e plumb i tretur.

.....
Po të mos të kisha njohur në mjerim të jetës Tinë,
Bukuril tmerisht e dashur, llaftari! tmerisht e bukur;
Po të mos të kisha parë - ah, stoli ndaj më je dukur!
Dritë-e fshehtë-e zemrës s'ime që më fal përjetësinë:

Si do mund t'i dlimja vallë kupëtimit t'im të ngushtë
Grop' e shesh e krast'e male, pasqyrim nër vala detesh,
Dritën që buçet sëfshehta përmes ditësh edhe netesh,
Dh'ata yj që më shëkojnë posi mijë sy të prushtë?

"Dritë fshehtësije" – Poradeci

31. Motivi kryesor i kësaj poezie lidhet me: 1 pikë
- A) dashurinë për natyrën, si ndjenjë që ushqen shpirtin poetik.
 - B) raportin e ngushtë të njeriut me vendlindjen e tij.
 - C) **përsiatjet e njeriut krijues në procesin e njohjes së thelbit të jetës.**
 - D) shmangiet filozofike në lidhje me mënyrën e krijimit të gjithësisë.
32. Lloji i vargut në poezi është: 1 pikë
- A) 13- rrokësh, sipas teknikave të vargëzimit bashkëkohor.
 - B) **16- rrokësh, sipas modelit të vargut naimian.**
 - C) 8- rrokësh, sikurse vargu i lirikës popullore.
 - D) 10- rrokësh, në ngjashmëri me vargjet e Eposit të kreshnikëve.
33. Imazhi i fuqishëm gjithëpërfshirës që krijohet në strofën e parë, vjen si rezultat i kombinimit të: 1 pikë
- A) antitezës – inversionit,
 - B) krahasimit – metaforës,
 - C) **shkallëzimit – apostrofës,**
 - D) pasthirmës – enumeracionit.
34. Mungesa e foljes në strofën e parë: 1 pikë
- A) detajon veprimin dhe ndihmon aksionin.
 - B) i jep të tjera ngjyresa veprimit.
 - C) thekson gjendjen shpirtërore të unit lirik.
 - D) **ngjesh imazhet dhe shpejton ritmin.**
35. Cili nga vargjet është ndërtuar mbi bazën e paradoksit? 1 pikë
- A) Ti përflakje mëngjezore! Harg ylberi-i shtatëngjyrshmë!
 - B) Dritën që buçet sëfshehta përmes ditësh edhe netesh,
 - C) **Bukuril tmerisht e dashur, llaftari! tmerisht e bukur;**
 - D) E prej sysh më bjenë lotë posi helm e plumb i tretur.

36. E gjithë pamja e harmonisë së pafund që shpaloset në vargje, krijon një kontrast kuptimor me vargun: **1 pikë**
- A) O ju qiej shkretëtirash tej-për-tej aq të këqyrshmë!
 B) Si do mund t'i dlinja vallë kupëtimit t'im të ngushtë
 C) Në me sulmë të vërtikshme çmëndurisht ju fluturoni,
 D) Po të mos të kisha parë - ah, stoli ndaj më je dukur!
37. Simbolika e **dritës së fshehtë**, që nis në titull dhe organizon gjithë poezinë, lidhet me: **1 pikë**
- A) frymëzimin poetik që buron nga thellësitë e zemrës.
 B) natyrën e mrekullueshme që i jep jetë gjithësisë.
 C) besimin tek drita e së vërtetës së perëndisë.
 D) bukurinë enigmatike të vashës që ngacmon zemrën e poetit.
38. Kuptimi i fjalëve **tmerisht** dhe **llaftari** në vargun: *Bukuril tmerisht e dashur, llaftari! tmerisht e bukur*, lidhet me: **1 pikë**
- A) befasinë nga uniteti në hapësirë e kohë, krijuar nga pushteti hyjnor.
 B) tronditjet shpirtërore që sjell dashuria për vashën, megjithë bukurinë e saj.
 C) fuqinë krijuese, si tronditje shpirtërore e artistit.
 D) frikën nga pafuqia e qenies njerëzore përballë pamjeve aq harmonike në natyrë.
39. Thelbi i përjetësisë në poezi buron nga: **1 pikë**
- A) thellësitë e panjohura të shpirtit artistik.
 B) bota iluzive e yjeve, hënës, diejve të zjarrtë.
 C) ditë - netët e zymta të natyrës njerëzore.
 D) qiejt e tejdukshëm e të pafund.
40. Cili varg mbështet përgjigjen e dhënë në pyetjen 39? **1 pikë**
- A) Dh'ata yj që më shëkojnë posi mijë sy të prushtë?
 B) E prej sysh më bjenë lotë posi helm e plumb i tretur.
 C) **Dritë-e fshehtë-e zemrës s'ime që më fal përjetësinë:**
 D) Botë yjsh! botë hënash! Botë djejs me gji të zjarrtë!
41. Cili nga vargjet e mëposhtme fiton të tillë muzikalitet që e afron ritmin e kësaj poezie me atë të një valleje? **1 pikë**
- A) **Në lëvisni-a në përdridhi, në valoni-a në këndoni,**
 B) Botë yjsh! botë hënash! Botë djejs me gji të zjarrtë!
 C) Po të mos të kisha parë - ah, stoli ndaj më je dukur!
 D) Dh'ata yj që më shëkojnë posi mijë sy të prushtë?
42. Kuptimi i fjalës së nënvizuar në vargun: *Si do mund t'i dlinja vallë kupëtimit t'im të ngushtë*, është: **1 pikë**
- A) gëzohem,
 B) çlirohem,
 C) gjunjëzohem,
 D) shmangem.
43. Cili nga vargjet e mëposhtme përmban një **epitet** tipik lasgushian, të krijuar sipas frymës organike të gjuhës shqipe? **1 pikë**
- A) **O ju qiej shkretëtirash tej-për-tej aq të këqyrshmë!**
 B) Bjenë fellë mënt' e mija dhe çuditën dyke pyetur.
 C) Po të mos të kisha njohur në mjerim të jetës Tinë,
 D) O greminë! O fusha pllajash! O shkëmbonj! O brigje t'artë!

44. Në cilin nga vargjet e mëposhtme sundojnë notat e trishtimit?

1 pikë

- A) Ti përflakje mëngjezore! Harg ylberi-i shtatëngjyrshmë!
- B) **E prej sysh më bjenë lotë posi helm e plumb i tretur.**
- C) Po të mos të kisha parë - ah, stoli ndaj më je dukur!
- D) Si do mund t'i dlinja vallë kupëtimit t'im të ngushtë

45. Kritika gjen në poezinë e Poradecit elemente të simbolizmit. Në dy vargjet e fundit të strofës së parë zbulojmë më së shumti përfaqje simbolike të tingujve dhe fjalëve me:

1 pikë

- A) ngjyrat dhe nuancat e tyre.
- B) notat muzikore të buta e të paqta.
- C) erërat dhe aromat.
- D) shijet e ëmbla apo të athëta.

Lexoni fragmentin e mëposhtëm dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim.

Dhe Apoli n'tokë prej koke i flaku kaskën
që ushtoi tu'u rrokullisë ndër kambë të kuajve,
me gjak e pluhun u flliq maja e kreshtës,
ajo që para kurrë provue s'e kishte
me u flliqë me pluhun që kur mbrojti ballin
krenar e l'hieshëm të Akil hynerit.
Por atbotë Zeusi deshi që Hektori
të mbante n'kokë atë tarogzë krife kali,
mbasi edhe atij iu afrue dita e fundit.
Heshta hiegjatë, vigane e paramune
me maje hekri n'dorë iu thye Patrokli,
edhe mburoja që der n'gju i rrinte,
këputun rrypi n'tokë i ra prej supi;
dhe prej kranorit ia shpërtheu parzmoren
i biri i Zeusit mbreti Feb Apoli.

Fjalor: e paramune – e parënë

"Iliada" - Homeri

46. Cila prej perëndive e ndihmon Hektorin për të dalë fitimtar në dyluftimin me Patroklin?

1 pikë

- A) Biri i Zeusit, Hefesti.
- B) Perëndesha e arsyes dhe mbrojtësja e arteve, Athinaja.
- C) Heroi ideal i kohërave homerike, Akili.
- D) **Biri i Zeusit, Feb Apoli.**

47. Situata e përcjellë në këtë fragment është:

1 pikë

- A) dramatike,
- B) realiste,
- C) **heroike,**
- D) sarkastike.



48. Në vargjet e mësipërme autori shtjellon kultin: 1 pikë
- A) e nderimit të të rënëve.
B) e heroizmit në fushën e betejës.
 C) e familjes në rrethanat e heroizmit masiv.
 D) e dashurisë që nuk njih kufij fisnorë.
49. Cili është raporti mes Patrokli dhe perëndive? 1 pikë
- A) Patrokli lufton heroikisht në emër të perëndive.
 B) Perënditë janë asnjnjëse, pasi luftën e bën Patrokli.
C) Edhe pse Patrokli lufton, fati i tij përcaktohet nga perënditë.
 D) Zeusi, edhe pse i pranishëm në fragment, nuk e ka në dorë fatin e Patrokli.
50. Cila prej teknikave të mëposhtme i ka shërbyer autorit për të organizuar rrëfimin në këtë fragment? 1 pikë
- A) Rimarrja e së njëjtës situatë.
B) Zhvillimi linear i aksionit.
 C) Përfshirja e vargjeve retrospektive.
 D) Përzjerja e vetave të ligjërit.
51. Nisur nga pikëpamja formale e këtyre vargjeve, cila nga alternativat shpalos tipare që e bëjnë fragmentin të llojit epik? 1 pikë
- A) **Prezenca e narratorit të gjithëdijshëm.**
 B) Prania e figuracionit të ngjeshur ndër vargje.
 C) Organizimi i fragmentit në vargje.
 D) Ritmi i brendshëm i vargjeve.
52. Nisur nga fragmenti, vdekja e Patrokli kalon nëpër këto kulme: 1 pikë
- A) Apoloni e qëllon në shpatulla; i thyhet heshta; i bie parzmorja nga kraherori.
B) i bie kaska nga koka; i thyhet heshta; i bie mburoja nga supi.
 C) i bie kaska nga koka; maja e kreshtës pluhuroset; Hektori mban në kokë tarogzën.
 D) maja e kreshtës ndyhet me gjak e pluhur; Hektori rrëmben tarogzën; i thyhet heshta.
53. Qëndrimi ideo-emocional i autorit kundrejt personazhit më të dashur për të sillet përmes *epitetit* në vargjet: 1 pikë
- A) me gjak e pluhun u flliq maja e kreshtës.
 B) Heshta hieqjatë, vigane e paramune/ me maje hekri n'dorë iu thye Patrokli,
 C) Zeusi deshi që Hektori/ të mbante n'kokë atë tarogzë krife kali,
D)që kur mbrojt ballin / krenar e t'hieshëm të Akil hynerit.
54. Duke u nisur nga fragmenti, cili nga tiparet e karakterit të Patrokli është tipik për heronjtë e eposit grek? 1 pikë
- A) **Heroi është luftarak dhe sprovohet në skena të luftërave të mëdha.**
 B) Heroi është fisnik, por i dobët dhe i pafuqishëm përballë sulmit të trojanëve.
 C) Heroi është besnik i idealeve të miqësisë dhe vëllazërisë reciproke.
 D) Heroi është hyjnor dhe i pandalshëm në betejë, për shkak të kësaj fuqie të mbinatyrshme që zotëron.

55. Për cilin nga personazhet (në vargjet e mësipërme) poeti jep një të dhënë të nënkuptuar mbi fundin e afërt të tij? 1 pikë
- A) Akilit,
 B) Patrokli,
 C) Hektorit,
 D) Feb Apolit.
56. Inversioni që shfaqet në vargun e tretë të këtij fragmenti e nxit lexuesin: 1 pikë
- A) të imagjinojë ngjyra dhe pamje të rënda lufte.
 B) të perceptojë sesi kreshta e Patrokli u ndot nga balta e mjedisit.
 C) të fokusohet tek objekti i përshkrimit.
 D) të përfitojë një kreshtë madhështore.
57. Cilat grupe fjalësh na tregojnë se kjo poemë i takon eposit homerik? 1 pikë
- A) Hyner, tarogzë, parzmore.
 B) Dorë, gju, sup.
 C) Krifë, albotë, heshtë.
 D) Krahnor, mbret, hijegjatë.
58. Detajet përshkruese në këtë fragment orientohen drejt hollësive të: 1 pikë
- A) ambientit ku zhvillohet ngjarja.
 B) veprimet luftarak të personazheve.
 C) të folurit të personazheve dialogues.
 D) mënyrës së vdekjes së heroit.
59. Figura kryesore mbi të cilën organizohet i gjithë imazhi i kësaj skene është: 1 pikë
- A) krahasimi,
 B) hiperbola,
 C) metafora,
 D) personifikimi.
60. Në vargun: *me gjak e pluhun u flliq maja e kreshtës*, fjala **u flliq** ka kuptimin: 1 pikë
- A) u çënuar,
 B) u dëmtuar,
 C) u turpëruar,
 D) u përlye.

